



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ....34..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21/ 02 / 2023

**VENDIM**

Nr.07, date 21 /02/2023

**PËR**

**RREGULLOREN E SHFRYTEZIMIT, OPERIMIT, MIREMBAJTJES, MONITORIMIT DHE SIGURISE SE DIGES SE HEC OSOJA**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.02.2023 mori në shqyrtim Rregulloren e shfrytëzimit, operimit, monitorimit dhe sigurisë së digës së HEC OSOJA të paraqitur nga Shoqëria Favina shpk.

Dokumentacioni i kësaj rregulloreje të dorëzuar pranë SKDM nuk ka përfshirë kërkesat e udhëzimit të KKDM në lidhje me hartimin e këtyre rregulloreve të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 3, dt.19.10.2020. KTPD i rekomandoi antarëve të KKDM të mos miratoj rregulloren për shfrytëzimin e digës së HEC Osoja. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të mos miratoj Rregulloren e Shfrytëzimit, Operimit, Mirembajtjes, Monitorimit dhe Sigurisë së digës së HEC OSOJA të paraqitur nga Shoqëria FAVINA shpk për arsye të mosplotësisë të kërkesave të legjislacionit të mësipërm dhe udhëzimeve përkatëse të KKDM .
- 2- Ti kërkoj shoqërisë FAVINA shpk:
  - Instalimin e sistemeve të monitorimit Hidrometeorologjik, sizmik dhe hidrogjeologjik (Piezometra) ë trupin e digës dhe dërgimin pranë KKDM të skemave dhe planimetrive të vendosjes së sistemeve të monitorimit të digës
  - Dorëzimin brenda muajit Mars pranë KKDM të të dhënave vjetore të vitit 2022 të matjeve të monitorimit gjeodezik, lëvizjeve të mundshme në digë dhe niveleve të ujrave nëntokesore të matura në digë.
  - Përgatitjen e hartave të përmytjeve duke u bazuar në llogaritjet e valës vërshuese dhe prurjeve maksimale të mundshme. Llogaritjet duhet të kryhen duke u bazuar në standarte teknike dhe programe bashkëkohore. Hartat duhet të japin të paktën thellësinë maksimale të ujit, shpejtësinë e lëvizjes së ujit, sipërfaqen e hartës si dhe numrin e njerëzve në rrezik në zonën poshtë digës duke u bazuar në rezultatet e llogaritjeve hidraulike përkatëse
  - Përditësimin e rregullores së shkarkimit të plotave të mëdha duke përfshirë edhe shkarkimet për shkak të prurjeve të mëdha që vijnë një herë në 50 vjet dhe një herë në 100 vjet. Për këto raste, kompania FAVINA shpk duhet të parashikoj informimin e institucioneve përkatëse duke përfshirë pushtetin lokal, prefekturën, AKMC dhe KKDM në kohe reale dhe përpara hapjes së portave të shkarkimit;

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

